

PREZANTIM DHE DISKUTIM I HAPUR

Masteri Profesional i Restaurimit të Monumenteve të Kulturës

Titulli i Prezantimit: Restaurimi nga CHwB Albania i 4 monumenteve të dëmtuara nga tërmeti në Durrës, Krujë dhe Prezë.

Konteksti: Kulla C e fortifikimeve në Durrës, Teqeja e Dollmës dhe Kulla e Sahatit në Kalanë e Krujës, si dhe Kulla dhe muret e fortifikimit të Kalasë së Prezës – janë 4 nga 53 monumentet e dëmtuara në tërmetin e nëntorit të vitit 2019. Në reagim të situatës së krijuar, CHwB Albania ka ngritur fondet si dhe procesin e nevojshëm për restaurimin e plotë të këtyre aseteve të rëndësishme kulturore. Aktualisht po vijohet me fazën e ndërhyrjeve konservuese, pasi janë përfunduar me sukses fazat e stabilizimit emergjent dhe studimi i detajuar e projektimi i masave konservuese, procese të cilat janë realizuar falë bashkëpunimit me një ekip të gjerë e ndërdisiplinor ekspertësh. Këto projekte financohen nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Fondi i Ambasadoreve për Trashëgiminë Kulturore të Sh.B.A, Ambasada e Sh.B.A. në Shqipëri, Prince Claus Fund dhe SIDA përmes CHwB Albania.

Struktura e prezantimit:

- Hyrje dhe prezantimi i të ftuarve dhe i sesionit – përfaqësuesi nga Masteri i Restaurimit – 5 minuta
- Prezantim pararak i programit të "Fondi i Ambasadoreve për Trashëgiminë Kulturore të Sh.B.A", përfaqësues nga Ambasada e Sh.B.A (për tu konfirmuar) – 5 minuta
- Prezantimi i 4 projekteve – Stafi i arkitektëve nga CHwB Albania – 40 minuta
- Pyetje dhe përgjigje – 10 minuta

Profili i CHwB Albania: CHwB Albania është një organizatë jo-qeveritare e përkushtuar ndaj shpëtimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore të prekshme dhe të paprekshme të rrezikuar nga konflikti, neglizhenca njerëzore dhe fatkeqësitë natyrore. Misioni i CHwB Albania është promovimi i trashëgimisë kulturore si një e drejtë në vetvete dhe një burim.

CHwB Albania punon me shoqërinë civile dhe institucionet e të gjitha niveleve për të forcuar paqtimin, zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe demokracinë, si dhe realizimin e të drejtave të njeriut.

Konservimi dhe restaurimi arkitektonik janë zemra e zanatit të CHwB Albania, me një numër të madh projektesh të realizuar në Berat, Gjirokastër, Korçë, Krujë, e gjetkë në Ballkan. CHwB Albania zhvillon gjithashtu rregullisht trajnime për studentë dhe profesionistë të rinj si Kampet Rajonale të Restaurimit që zhvillohen në Shqipëri dhe rajon çdo vit.